

Takimi X i Grupit të Punës të EUROSAT-t për Auditimin e Fondeve të Alokuarat për Fatkeqësitë dhe Katastrofat (WGAFADC)

Varshavë, 22-23 prill 2024



Takimi X i Grupit të Punës të EUROSAT-t për Auditimin e Fondeve të Alokuarat për Fatkeqësitë dhe Katastrofat (WGAFADC) u zhvillua në Varshavë, në datat 22-23 prill 2024.

Në takim morën pjesë përfaqësues nga Institucionet Supreme të Auditimit, anëtarë të këtij grupi pune si, Ukraina, Polonia, Gjeorgjia, Shqipëria, Bullgaria, Estonia, Serbia, Moldavia, Italia, Rumania, Sllovakia, si dhe nga Gjykata Evropiane e Audituesve.

Tema e këtij takimi, i cili shënonte edhe përvjetorin e dhjetë të krijimit të këtij grupi pune ishte: “10 vjet WGAFADC: arritjet, sfidat dhe perspektiva”.

Në hapje, z. Piotr Miklis, Zv. president i Zyrës Supreme të Auditimit të Republikës së Polonisë, theksoi rëndësinë e veprimtarisë së grupit të punës dhe shprehu mbështetjen për Ukrainën në luftën kundër agresionit rus.

Në fjalën e saj, znj. Olha Pishchanska, Kryetare e SAI-t të Ukrainës, falënderoi të gjitha Institucionet Supreme të Auditimit, anëtarë të grupit, për punën e frytshme dhjetëvjeçare.

Z Viktor Bohun, nga SAI i Ukrainës, paraqiti Raportin e Progresit të WGAFADC-së për periudhën 2021-2024, ku vuri në dukje se krizat ekonomike dhe konfliktet e armatosura në pjesë të ndryshme të botës, krijojnë rreziqe të reja për stabilitetin dhe sigurinë.

Në fjalën e tij, ai theksoi se këto kriza ndikojnë në flukset e migracionit, shkaktojnë paqëndrueshmëri sociale dhe minojnë përpjekjet për zhvillim të qëndrueshëm. Në përgjigje të këtyre sfidave, grupi i punës duhet të punojë në mënyrë aktive për të zhvilluar dhe zbatuar qasje dhe rekomandime inovative për qeveritë, për të përmirësuar sistemet e parandalimit dhe reagimit ndaj fatkeqësive.

Gjatë dy ditëve të takimit, pas prezantimeve të auditimeve të realizuara nga SAI-t në lidhje me katastrofat natyrore, Grupi i Punës i EUROSAT-t për Auditimin e Fondeve të Alokuarat për Fatkeqësitë dhe Katastrofat miratoi (i) projekt-Rezolutën për zgjatjen e mandatit të grupit të

punës deri në vitin 2027 duke mbështetur gjithashtu, zgjatjen e kryesimit nga SAI i Ukrainës për periudhën e ardhshme trevjeçare dhe (ii) draft Planin Strategjik të Grupit për periudhën 2024-2027.

Në fund të muajit maj 2024, dokumentet do të paraqiten për miratim në Bordin Drejtues dhe në Kongresin e EUROSAT-t.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë takim, u përfaqësua nga z. Aldo Kume dhe znj. Joniada Goçaj, auditues pranë Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore.